



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 4672/11 prot.

Pogradec, më 14.11.2023

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj.MANJOLLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për: **“Për një shtesë në VKB Nr.94 datë 28.08.2023, për Dhënie E Dakortësisë, Për Vijimin E Procedurave Të Heqjes Nga Fondi Pyjor Publik Të Sipërfaqes Pyjore Prej 0.994 (Zero Presje Nëntëqind e nëntëdhjete e katër) Ha, E Ndodhur Në Ekonominë Pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Talle), për ndërtim hidrocentrali “Shpella Poshtë II”, Nga Shoqëria “Liria Energji” Shpk”.**

Me respekt,

KRYETARI

Hir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues të projekt vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të Raportit Tekniko-Ekonomik dhe relacionit teknik të projekt vendimit: 12

Nr. i fletëve A4 të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2023

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, DATË ____ . ____ .2023

PËR

NJË SHITESË NË VKB NR.74 DATË 28.08.2023, PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIMIN E HEC-IT "SHPELLA POSHTË II", VEPËR MARRJE (DIGË DHEU) SIPËRFAQEJE PYJORE PREJ 0.994 HA NË EKONOMINË PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE TALLË) NGA SHOQËRIA "LIRIA ENERGJI" SHPK.

Ligji Nr.8417, date 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomies vendore", të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27 dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligji Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", pikës 4 të nenit 5 të Ligjit Nr.57/2020, "Për Pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", pikës 23 të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore". Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 22 date 09.01.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të Administrimit të pyllit Komunal, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 510, date 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", Këshilli Bashkiak:



VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore prej **0.994 ha** pyll në Ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Talle), në ngastrat/nëngastrat nr.1/a (0.7215 ha), nr.33/a (0.2725 ha), për ndërtimin e veprës së marrjes (digë dheu), nga shoqëria "LIRIA ENERGJI" SHPK.
2. Shprehja e dakortësisë do ti dërgohet Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, për vijimin e procedurave ligjore të heqjes nga fondi pyjor/kullosor.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike dhe Shërbimi Pyjor për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore").
5. U shpall sot më datë ____ . ____ .2023.

KRYETARE E KËSHILLIT TË BASHKISË

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2023

RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN
ME OBJEKT:

“PËR

“SHTESË NË VKM NR.74 DATË 28.08.2023, PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR PUBLIK TË SIPËRFAQES PYJORE PREJ 0.994 (ZERO PRESJE NËNTËQIND E NENTËDHJETE E KATËR) HA, E NDODHUR NË EKONOMINË PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE TALLË), PËR NDËRTIM HIDROCENTRALI “SHPELLA POSHTË II”, NGA SHOQËRIA “LIRIA ENERGJI” SHPK”.

**E NDERUAR KRYETARE E KËSHILLIT!
TË NDERUAR KËSHILLTARË!**

KREU I

HYRJA DHE PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË

Ndër të tjera, pranë Bashkisë Pogradec është e krijuar dhe funksionon Drejtoria e Shërbimit Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave, në të cilën janë të përqëndruara pothuajse të gjitha funksionet e deleguara nga Pushteti Qëndror, të cilat janë:

1. *Shërbimi Pyjor.*
2. *Inspektoriati i Pyjeve.*

Administrimi i i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Pogradec është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **“Funksionet e Bashkive në fushën e buqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:** Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

KREU II

INTERPRETIMI I BAZËS LIGJORE

Referuar pikes 5 te nenit 27 te Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu referuar shkronjave "e" të nenit 54 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, parashikon se, është Këshilli i Bashkisë ai që:



e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

Mbështetur në pikën 4 nenit 5 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet" Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në vendimin Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e bashkive".

Proçedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik janë të mbështetura në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", në VKM-ve nr.1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik".

Per sa me sipër, duke krijuar bindjen që projekt vendimi është në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore dhe se dokumentacioni shoqerues është i plotë, Jini të lutur të miratoni projekt vendimin bashkëngjitur.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi: SPECIALIST

KLEDI LUFO

Pranoi: DREJTOR

ARIAN MINGA

Miratoi: NËNKRYETAR

PASKALINO ZIKO

Konfirmoi: KRYETAR

ILIR XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

RELACION
PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT

MBI

NJË SHITESË NË VKM NR.94 DATË 28.08.2023, PËR TRAJTIMIN E SHKRESËS NGA SHOQËRIA “LIRIA ENERGJI” SHPK PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR SIPËRFAQES PREJ 0.994 HA, ME KËRKESË TË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
(Ndërtim Hydrocentrali Shpella Poshtë II)

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARE !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe referuar shkresës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbatje si më poshtë:

1. Baza ligjore:

Në mbështetje të; nenit 8 pika 2, nenit 27 pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, pika 4 nenit 5 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht

në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", pikes 23 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore". Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 22 date 09.01.2008 "Per per caktimin e procedurave dhe kritereve te Administrimit te pyllit Komunal, Vendimin e Këshillit te Ministrave Nr.510, date 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupëzuara e te patrupëzuara", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", të ndryshuar.

2. Proçedura e ndjekur dhe dokumentacioni i dorëzuar:

Referuar shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.6030/1 prot, datë 23.10.2023 me lëndë: "mbi dërgimin e dokumentacionit për ndërtimin e Hec-ve", drejtuar Bashkisë Pogradec.

Mbështetur në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.94 datë 28.08.2023 "Për dhënien e dakortësisë për vijimin e proçedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik për ndërtimin e hecit "shpella poshtë 2", vepër marrje (digë dheu) sipërfaqe pyjore prej **0.994 ha** në ekonominë pyjore Bishnicë (pjesa ekonomike tallë), nga Shoqëria "Liria Energji" Shpk, në shkresën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kërkohet të shtohet zëri kadastral pyjor në pikën 1 të VKB Nr.94/2023, mbështetur në Vendimin të Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".

3. Bashkëlidhur relacionit i bashkëngjiten dokumentat e mëposhtëme:

- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.94 datë 28.08.2023
- Raportin e Tekniko Ekonomik dhe relacionin shpjegues
- Shkresa e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit
- Konofirmimin e Prefektit të Qarkut për vendimin 94/2023.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptuan:

Inxhinier Pyjore:

Ing. KLEDI LUFO



Pranoi:

PËRGJEGJËS SEKTORI

Ing. ARBEN BRAHO

A blue ink handwritten signature, appearing to be "Arben Braho", written in a cursive style.

Miratoi:

DREJTORI

ARIAN MINGA

A blue ink handwritten signature, appearing to be "Arian Minga", written in a cursive style.

Konfirmoi:

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI

A blue ink handwritten signature, appearing to be "Ilir Xhakolli", written in a cursive style.



1309/3
24.10.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT
DREJTORIA E NATYRËS DHE PYJEVE



Nr. 6030/1 prot.

Tiranë, më 23.10.2023

Lënda: Mbi dërgimin e dokumentacionit për ndërtimin e Hec -eve

BASHKISË POGRADEC
Bulevardi "Reshit Çollaku", Lagja nr.2, POGRADEC

Në vijim të shkresës suaj nr. 1309/2 prot., datë 2.10.2023 "Dërgohet raporti tekniko-ekonomik", lidhur me ndërtimin e Hec "Shpella Poshtë II", dhe shkresës suaj nr. 1129/2, datë 2.10.2023 "Dërgohet raporti tekniko-ekonomik", lidhur me ndërtimin e Hec-eve "Zgallo 1 & 2", në bashkinë Pogradec, Ju informojmë se:

Sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III, të V.K.M. nr. 888, datë 27.12.2022, në funksion të qartësisë dhe shmangies së interpretimeve, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka kërkuar që Vendimi i Këshillit Bashkiak të përmbajë specifikimet me ngastrat pyjore/kullosore dhe ekonominë pyjore/kullosore, si dhe aktivitetin për të cilin miratohet heqja nga fondi pyjor, sipas draftit të dërguar me shkresë zyrtare.

Vendimi i Këshillit Bashkiak të Pogradecit, nr. 93, 94, datë 28.08.2023, pika 1, nuk përmban informacion kadastral se në çfarë ngastre hiqet sipërfaqja ku ndërtohen hec-et, për të bërë të mundur ndryshimet kadastrale, pas miratimit të heqjes së kësaj sipërfaqe të përfshirë në këtë vendim të këshillit bashkiak.

Për sa më sipër, mbetemi në pritje të qartësimin të këtyre dokumentave.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

LEDINA BEQIRAJ AGALLIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3333/Prot.
4

Pogradec, më 28.08 2023

VENDIM

Nr. 94, DATË 28.08, 2023

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIMIN E HEC-IT "SHPELLA POSHTË II", VEPËR MARRJE (DIGË DHEU) SIPËRFAQEJE PYJORE PREJ 0.994 HA NË EKONOMINË PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE TALLË) NGA SHOQËRIA "LIRIA ENERGJI" SHPK.

Ligji Nr.8417, date 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomies vendore", të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikes 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27 dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligji Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", pikës 4 të nenit 5 të Ligjit Nr.57/2020, "Për Pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", pikes 23 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore". Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 22 date 09.01.2008 "Per përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të Administrimit të pyllit Komunal, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 510, date 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", Këshilli Bashkiak:





VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore prej **0.994 ha** pyll në ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Talle), për ndërtimin e veprës së marrjes (digë dheu), nga shoqëria "LIRIA ENERGJI" SHPK.
2. Shprehja e dakortësisë do ti dërgohet Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit për vijimin e procedurave ligjore të heqjes nga fondi pyjor/kullosor.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtorja Juridike dhe Prokurimeve Publike dhe Shërbimi Pyjor për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore").
5. U shpall sot më datë 28.08.2023.



KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



Basilika Korçë

Nr. 3333/7 Prot

dt 09.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË



Nr. 743/1 Prot.

Korçë, dt 09.09.2023


Lënda: Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC

KRYETARIT TË BASHKISË POGRADEC

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të vendimeve nr. 91, nr. 93, nr. 94, datë 28.08.2023, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre**, bazuar në nenin 3, 8, 9, 27, 34, 40, 54, 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 27.09.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.398, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime në nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", në pikën 23 të udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor".

PREFEKTI
NERTIL JOLE



Nertil Jole

Adresa: L. 7 Rr. "28 Nëntori", Tel: 08224 2953 , e-mail: Prefekti.Korce@mb.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA POGRADEC

RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR HEQJE NGA FONDI PYJOR DHE
KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE 0.99 HA QË PREKEN NGA NDËRTIMI I HECIT
"SHPELLA POSHTË II", NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË POGRADEC, ME
KËRKESË TË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT.

(SHOQËRIA "LIRIA ENERGJI" SHPK)

Bazuar në shkresën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.113/5 prot. datë 28.03.2023, "për përgatitje të raportit tekniko-ekonomik për ndërtimin e hecit "Shpella Poshtë II", Urdhërin Nr.163 datë 30.03.2023 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin mbi hartimin e raportit tekniko-ekonomik, për trajtimin e shkresës nga shoqëria "Liria Energji" shpk për heqjen nga fondi pyjor/kullosor, me kërkesë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, grupi i punës i përbërë nga: Ing.Arben BRAHO Përgjegjës i Sektorit të shërbimit Pyjor, Ing.Kledi LUFO specialist i pyjeve, Ing.Markeljan VELILLARI specialist i pyjeve dhe kullotave nga data 30.03.2023 deri në datën 03.04.2023 studjoi kërkesën dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore që hiqen nga fondi pyjor/kullosor për ndërtimin e Hecit "Shpella Poshtë II, objekt ndërtim dige dheu.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezultojnë që sipërfaqja e kërkuar është **0.99 ha**, dhe shtrihet në ngastrat/nëngastra: **1a; 33a** bën/bëjnë pjesë në Ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa ekonomike Tallë), *objekt heqje nga fondi pyjor/kullosor* dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Pogradec.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit, pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezultojnë kjo gjëndje: *(lexo tabelat përkatëse 1 dhe 2)*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqëria "Liria Energji" Shpk, ngastrat: **1a, 33a** bën/bëjnë pjesë në Ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa ekonomike Tallë), *ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesor të grumbullit me një sipërfaqe 0.99 ha, (ndërtim dige dheu)* sipas formularit nr.5 të këtij raporti, dhe pakson volumin në **104.8 m³** dru zjarri të llojit Ah dhe Lis në ngastrat e mësipërme, pjesë e ekonomisë pyjore Bishnicë (Pjesa ekonomike Tallë).

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", në VKM-ve nr.1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të

shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullor bazohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”. “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Shuma prej 66880 lekë/vit, konsiston në:

a) Ose a/1) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km lekë, e përbërë nga:

Trungishte – _____ km x _____ lek = _____ lekë

Cungishte – _____ km x _____ lek = _____ lekë


Kullotë – _____ km x _____ lek = _____ lekë

b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 66880 lekë, e përbërë nga:

1. Vlera e lëndës së punimit 0 lekë
2. Vlera e druve të zjarrit 62880 lekë
3. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 2500 lekë
4. Kullotja 0 lekë
5. Vlera e faunës 1500 lekë
6. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj) _____ lekë.
7. Të tjera _____ lekë

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing. Kledi LUFO



Ing. Markeljan VELILLARI



Ing. Arben BRAHO



DREJTORI I NMIPP
Enton BERBERI



MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË
ILIR XHAKOLLI



BASHKIA POGRADEC
 NDERMARRJA E IRREGULARITJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE
 SEKTORI I SHËRBIMIT/KJOR

PASOYRË E PËRSHKRIMIT PARCELAR (sipas regjistrit kadastral)
 (Ndërtim Hidrocentrali Shpella Poshtë II)

Tabela 1

ID. Pronës	Ekonomia Pjyore	Parc	Perb. Grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Të dhëna të grumbullit pyjor				Fugia lëndore				
						Mosha	K.D	D			Nën pylli	Katet per ha		
								mes	Lart. mes				Total	
KO29 2 001	Bishnicë Pj.Ek.Tallë	1a	90% Ah+10% PAM	Prodh.	Trungishte	190	0.7	27	11	Ekziston	Mungon	N	229.2	5936.2
KO29 2 033	Bishnicë Pj.Ek.Tallë	33a	100% QA	Prodh.	Cungishte	20	0.8	18	8	Ekziston	Dek,Bsh	N	164.6	2564.9
Totali														8501.1

PASOYRË E PËRSHKRIMIT PARCELAR (sipas verifikimit në terren)

(Ndërtim Hidrocentrali Shpella Poshtë II)

ID. Pronës	Ekonomia Pjyore	Parc	Perb. Grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Të dhëna të grumbullit pyjor				Fugia lëndore				
						Mosha	K.D	D			Nën pylli	Katet per ha		
								mes	Lart. mes				Total	
KO29 2 001	Bishnicë Pj.Ek.Tallë	1a	95% Ah+ 5 %QA	Prodh.	Trungishte	180	0.7	27	18	Ekziston	Mungon	N	130.8	1922.76
KO29 2 033	Bishnicë Pj.Ek.Tallë	33a	100% QA	Prodh.	Cungishte	30	0.6	16	10	Mungon	Dek,Muz	N	34	979.2
Totali														2902.0

GRUPI I PUNËS

Ing. Klodi LUFO



Drejtori i NMIPP
 Enton BERBERI

Ing. Markeljan VELLILLARI



Përgjegjësi i Sektorit
 Ing. Arben BRAHO





Formulari Nr.4

TABELA PËRMBLEDHËSE E VLËRESIMIT FINANCIAR
(Nëntim Hidrocentrali Shpella Postë II)

Përdorimi i territorit	Sipërfaqja	Bashkia	Volumi m ³	Sipas asortimenteve	Vlera		Gjatesia	Tarifa dhënie në përdorim lek/km/vit			Shuma II	Totali I+II
					lek/m ³	Shuma I		Perd. km	1	2 deri 5		
0	1	2	3		4	5	6	7	8	9	10	11
Trungështite	0.72	Pogradec	Dru zjarri 94.1 m ³	600	56460							56460
Cungështite	0.27	Pogradec	Dru zjarri 10.7 m ³	600	6420							6420
Shkurre												0
Kullotë												
B.pyjore+Djerr												
Inprodukt												
Bimë mjek/med												2500
Gjuetia												1500
Invest realizuar												
Të tjera												
Gjithsej	0.99		Dru zjarri 104.8 m ³									66880

GRUPI I PUNËS

Ing. Kledi TSUFO

Ing. Markeljan VELLILLARI

Drejtori i NMIPP
Enton BERBERI

Përgjegjësi i Sektorit
Ing. Arben BRAHO

(Ndërtim Hidrocentrali Shpella Poshtë II)

Formulari Nr. 5

Nr.	ID Pronës	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ng/ngastrat	Sipërfaqja që hiqet nga Fondi Pyjor Ha	Sipërfaqja që jepet në përdorim nga fondi pyjor/kullosor Ha	Gjatësia në përdorim Km		
						Rrugë	Linjë	Tubacion/kanal
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	KO29 02 001	Bishnicë pj.ek. Tallë	1a	0.7215		0	0	0
2	KO29 02 033	Bishnicë pj.ek. Tallë	33a	0.2725				
Shuma				0.99				

GRUPI I PUNËS

Ing. Kledi LUFO



Drejtori INMIPP


Anton BERBERI

Ing. Markeljan VEJILLARI



Përgjegjësi i Sektorit

Ing. Arben BRAHO





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI



**RELACION
PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT**

MBI

HARTIMIN E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK, PËR TRAJTIMIN E SHKRESËS NGA SHOQËRIA “LIRIA ENERGJI” SHPK PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR SIPËRFAQES PREJ 0.994 HA, ME KËRKESË TË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

(Ndërtim Hidrocentrali Shpella Poshtë II)

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !


TË NDERUAR KËSHILLTARE !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe referuar shkresës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbatje si më poshtë:

1. Baza ligjore:

Në mbështetje të; nenit 8 pika 2, nenit 27 pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, pika 4 nenit 12 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", pikes 23 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike,

si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 22 date 09.01.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të Administrimit të pyllit Komunal, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 510, date 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzara e të patrupëzuar", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, të ndryshuar.



2. Procedura e ndjekur dhe dokumentacioni i dorëzuar:

Referuar shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.113/5 prot, datë 28.03.2023 me lëndë: “Për përgatitje të raportit tekniko – ekonomik për ndërtimin e Hec-it Shpella Poshtë II, nga Shoqëria “LIRIA ENERGJI” SHPK, drejtuar Bashkisë Pogradec.

Shoqëria “LIRIA ENERGJI” SHPK ka paraqitur në MTM kërkesën për heqje nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqeve që ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit si: ndërtim vepër marrje (digë dheu).

Struktura e shërbimit pyjor pjesë e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, pas marrjes së kërkesës dhe shqyrtimit të dokumentacionit, u ngrit grupi i punës për hartimin e Raportit Tekniko – Ekonomik, në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Nr.163 datë 30.03.2023, nga verifikimi i kryer në terren në përputhje me të dhënat e rregjistrimit kadastral pyjor/kullosor rezultojnë që sipërfaqja e kërkuar është **0.994 ha**, dhe shtrihet në ngastrat: **1a, 33a** bëjnë pjesë në Ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa ekonomike Tallë), **objekt heqje nga fondi pyjor/kullosor** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Pogradec, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", sipas listës së inventarit”.

Mbështetur në kontratën e qerasë Nr.5182 prot datë 11.07.2018 që shoqëria “Liria Energji” Shpk ka lidhur me Bashkinë Pogradec, për përdorim të fondit pyjor kullosor të sipërfaqes që preken, nga ndërtimi i hidrocentralit Shpella Poshtë 2, si dhe kontratës konçesionare Nr.6004.Rep datë 24.05.2013 të lidhur midis palëve të shoqërisë “Liria Energji” Shpk me Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës.

Shoqëria “Liria Energji” Shpk në kontratën shtesë Konçesionare Nr.1329 Rep, Nr.429 Kol datë 10.05.2022 të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për shtimin e një vepër marrje (digë dheu) e cila do të ndërtohet në përroin e zallit me një lartësi 14m. Projekti i zbatimit të ndryshuar të hec-it “Shpella Poshtë II”, është miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.74/1 datë 03.02.2022, gjithashtu dhe raporti i oponentes teknike mbi projektin e zbatimit të ndryshuar të Hec-it “Shpella Poshtë II”, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Drejtoria e Monitorimit të hidrocentraleve Nr.46/5 datë 09.03.2021. Për ndërtimin e vepërës së marrjes është nënshtruar dhe hartimin e VNM-së paraprake ndërmjet Shoqërisë “Liria

Energji” Shpk dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Vlersimit të Impaktit dhe Liçensimit AN210120230001 datë 20.03.2023, në të cilën projekti nuk duhet ti nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar.

Studimi tekniko-ekonomik u bë në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kerkimit, shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim/heqje, të fondit pyjor/kullosor publik, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.537 datë 22.09.2021 “për përcaktimin e kostove të përlloraritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”, në piken 1 të këtij vendimi citohet: Subjektet përfituese, për të cilat është miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit pyjor kombëtar, paguajnë paraprakisht kostot e përlloraritura për pyllëzimin kompensues përkatës, si rezultat i ndryshimit të destinacionit të përdorimit të fondit pyjor të lejuara nga ligji për rigjenerimin dhe kthimin në gjendjen natyrore të njëjtë ose të përafërt me atë të sipërfaqes pyjore të cenuar për shkak të ndryshimit të destinacionit.

Sipërfaqet që do të hiqen nga fondi pyjor/kullosor janë pasqyruar në formularin nr.5 kollona 5, **0.994 ha**, këtu përfshihen ndërtim vepër marrje (digë dheu), dhe pakson volumin në **104.8 m³** dru zjarri të llojit Ah dhe Lis në ngastrat e mësipërme, pjesë e ekonomisë pyjore Bishnicë (Pjesa ekonomike Tallë).

3. Bashkëlidhur relacionit i bashkëngjiten dokumentat e mëposhtëme:

- Vlersimin e ndikimit në Mjedis paraprak.
- Këkresen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit “Për përgatitje të Raportit Tekniko-Ekonomik”, drejtuar Bashkisë Pogradec.
- Rilevimet (plan vendosjet), ku mbivendoset vepra e marrjes.
- Projekti i Zbatimit niveli i dytë i hidrocentralit “Shpella Poshtë 2”.
- Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë Pogradec Nr.163 datë 30.03.2023 Mbi hartimin e Raportit Tekniko-Ekonomik nga Shoqëria “Liria Energji” Shpk.
- Kontratë konçesionare Shtesë të formës “BOT”.
- Ekstrakti i regjistrimit tregëtar.
- Miratimi i projektit të zbatimit të ndryshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës.
- Raporti i oponencës teknike mbi projektin e zbatimit të ndryshuar Hec-it “Shpella Poshtë 2” nga AKBN.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,



PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptuan:

Inxhinier Pyjore:

Ing. KLEDI LUFO



Inxhinier Pyjore:

Ing. MARKELJAN VELILLARI

Pranoi:

PËRGJEGJËS SEKTORI

Ing. ARBEN BRAHO

Miratoi:

DREJTORI N.M.I.P.P

ENTON BERBERI

Konfirmoi:

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI